

Prot. 2211/216 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Kombëtare Konservatore Albania*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin PKKA, KRIIK ka konstatuar se:*

- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *raporti i dorëzuar nuk është në formatin e miratuar nga KQZ;*
- *mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.*

Lidhur me financierin njëkohësisht edhe kandidat

Referuar raportit të vetëdeklarimit dhe listës shumëemërore të kandidatëve të Partisë Kombëtare Konservatore Albania, financieri z. Rozher Prifti është edhe kandidat i Koalicionit ABEOK, ku kjo parti bën pjesë, me numër rendor 4 në Qarkun Korçë.

Lidhur me formatin e raportit të depozituar në KQZ

PKKA, referuar raportit të vetëdeklarimit të publikuar në faqen e internetit të KQZ, si dhe kopjeve të vëna në dispozicion të KRIIK nga KQZ, rezultojnë të ketë depozituar një shkresë e cila nuk është në formatin e miratuar nga KQZ-ja.

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezultojnë se PKKA nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

Për Koalicionin Për Reforma, Integrim

dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania